

## Mbledhje e Komitetit Teknik 19

“Produkte nafte, lubrifikant dhe produkte që lidhen me to,,



Me propozimin e Kryetarit të Komitetit 19 “**Produkte nafte, lubrifikant dhe produkte që lidhen me to,,** z. Ilia Gjermani, më 10 Nëntor 2010 në mjediset e DPS u mbajt mbledhja e këtij Komiteti.

Qëllimi ishte shqyrtimi dhe krahasimi i dy standardeve puro shqiptare për tju përgjigjur sa me mirë tregut të karburanteve kur nga data 1 Janar 2011 sipas VKM 147 date 21.03.2007 në territorin e Republikës së Shqipërisë do të

lejohet të përdoret vetëm lëndë djegëse për motorë djezel dhe gjeneratorë me përmbajtje squfuri jo më të madhe se 10 mg/kg.

Morën pjesë:	Ilia Gjermani	Kryetar;
	Pëllumb Metohu	Sekretar;
	Miranda Sharkaj	Anëtare;
	Brikena Xhajo	Anëtare;
	Rozeta Kokonozi	Anëtare;
	Alqi Pogaçe	Anëtar;
	Dritan Spahiu	Anëtar.

### Rendi i ditës:

- Krahasimi, nëse specifikimet teknike të dhëna në standardin shqiptar S SH 4497:2010 me titull "Lëndët djegëse për ngrohje industriale dhe shtëpiake – Kërkesat dhe metodat e provës" janë të njëjta me ato të standardit S SH 3650:1986 me titull "Lëndë djegëse e lëngët për kaldaja" dhe se a duhet zëvendësuar S SH 3650:1986 me S SH 4497:2010.
- Evidentimi dhe shfuqizimi i standardeve puro shqiptare S SH nëse ato bien ndesh me standardet europiane EN.

Fjalën e hapjes e mbajti sekretari i komitetit i cili i uroj mirëseardhjen pjesëmarrësve dhe i njohu ato me rendin e ditës

Në fjalën e tij Kryetari i KT 19 vlerësoi punën paraprake të anëtarëve të komitetit në lidhje me krahasimin e dy standardeve.

Në fund të diskutimeve u vendos unanimitisht që standardi i ri S SH 4497:2010 me titull "Lëndët djegëse për ngrohje industriale dhe shtëpiake – Kërkesat dhe metodat e provës" **nuk e zëvendëson** standardin S SH 3650:1986 me titull "Lëndë djegëse e lëngët për kaldaja".

Gjithashtu gjatë diskutimeve u evidentua se ekzistonte mundësia e bërjes së disa ndryshimeve në standardin ekzistues S SH 4497:2010 të disa specifikimeve teknike me qëllim zgjerimin e fushës së këtij standardi. Për këtë qëllim u ngrit një grup pune për të rishikuar specifikimet teknike dhe për t'ia paraqitur ato KT 19 në një mbledhje tjetër. Grupi i punës do të përbëhet nga Ilia Gjermani, Alqi Pogaçe dhe Rozeta Kokonozi.



Në përgjigje të pikës 2 dhe me porosi të veçantë të Drejtorit të Përgjithshëm të DPS, Z. Bashkim MUÇA, nga sekretari i KT, u shpërnda lista e plotë e standardeve puro shqiptare S SH, e cila do të shqyrtohet dhe përditësohet nga anëtarët dhe standardet e evidentuara për shfuqizim do të propozohen në programin e punës për vitin 2011.